



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.452/7 prot.

Datë 06 .03.2024

**V E N D I M**

**Nr. 246/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06 .03.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “E hapur e thejshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024 me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lushnje SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr. 8240, Njësia Nr.6, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lushnje SH.A  
me adresë: Lagja “ 18 Tetori ” Lushnje"
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit

*Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-95992-02-21-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

II.2. Në datën 23.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3830 dhe me nr. 452/2024 prot., datë 26.02.2024, e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, protokolluar me tonën me nr. 452/2, datë 29.02.2024 dhe përmes shërbimit postar protokolluar me tonën me nr. 452/3 prot., datë 01.03.2024, i cili ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, duke argumentuar: “[...] Në lidhje me ankesën e paraqitur, na u vendos në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm: Procesverbali i hartimit të kriterëve. Dokumentet Standarde të Tenderit. Nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve që subjekti ka kërkuar janë si më poshtë vijon: Në kapitullin e Specifikimeve Teknike pika 2.3.3 thuhet: 2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit)

- Për pretendimin e ngritur në pikën 2.3.3. nga Operatori Ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për ndryshimin e specifikimeve teknike, për të pranuar vetëm elementët që kryen ISHP-ja dhe modifikimit të standardit S SH EN 937:2016 të po atij standardi që ISHP kryen, si organi më i lartë përgjegjës dhe Laboratori i vetëm i akredituar në Republikën e Shqipërisë për kryerjen e Analizave të Hipoklorit Kalciumi. Pretendimi i Operatorit Ekonomik qëndron pjesërisht dhe duhet të bëhet ndryshimi në Specifikimet Teknike si më poshtë:

a) Specifikimet janë hartuar në përputhje me standardet Shëndetësore Shqiptare përkatëse, konkretisht: - Hipoklorit i Natriumit - Hipoklorit Kalciumi S SH EN 901:2013

b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit) në sistemin elektronik fletë e analizë për elementët që Instituti i Shëndetit Publik nuk i realizon, duhet të sjellë fletë analizë të metaleve të rënda nga një laborator i licencuar (vendas ose të huaj), Qendra Kërkimore 4 (IKV, IFBZ), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë (Densiteti), apo Universitare që ka kapacitet dhe aparatura që analizojnë metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpërmendura. (Për të gjithë elementët të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik).

#### VENDOSI:

Bazuar në shqyrtimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, ankesa e Operatorit Ekonomik “Albania Distribution Chemicals Sh.p.k” të pranohet pjesërisht.

Në zbatim të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, neni 102, kjo shkresë do t’ju dërgohet në rrugë shkresore si dhe në adresën elektronike që ju keni përcaktuar në formularin e ankesës.

Ky formular do ti dërgohet gjithashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

II.5.Me datë 01.03.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve i cili u protokollua me tonën me nr. 452/4 prot, datë 01.03.2024 duke argumentuar: *“Diten e sotme date 01.03.2024, kemi mare pergjigjen ( gjeni bashkangjitur ) e Autoritetit Kontraktor ne lidhjeper ankesen tone.*

*Fillimisht duam te themi se AK nuk i ka trajtuar kriteret qe ne kemi bere ankesen, por na ka kthyer pergjigje vetem per nje kriter.*

*Se pari: ne pergjigjen e tij AK ka kthyer nje pergjigje duke bere nje ndryshim dhe duke cituar se “OE duhet te sjellin flete analize te laboratoreve te licencuar si Qendra Kerkimore 4 (IKV, IFBZ ), Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Tirane ( Densiteti ), apo Universitete qe ka kapacitetet etj. Persa i perket Qendra Kerkimore 4 (IKV, IFBZ ) ashtu sic ju kemi paraqitur edhe tek Ankesat A/2023/3699, A/2023/3698, A/2023/3697, asnje nga keta Laboratore nuk kryen keto analiza. Per me teper keto laboratore nuk jane te Akredituar nga DPA (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> ). Gjithashtu edhe Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Tirane nuk eshte nje laborator i akredituar.*

*1. Kerkojme pranohet flet analiza e Institutit te Shendetit Publik si organi me i larte pergjegjes per analizat e kimikateve te trajtimit te ujit ( me ato elemente qe ISHP kryen ) dhe mos te jete kusht per skualifimik.*

*2. Ose Autoriteti Kontraktor te percaktoje qarte me Emer dhe adrese kush jane Labororet e akredituar qe kryjne analizat per Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi per elementet te Institutit i Shendetit Publik ( ISHP ) nuk kryen. ( perpara se te japi emrat AK duhet te mare informacion te qarte tek labororet qe do adresojne nqs i kryejne apo jo kete analiza )*

*Se dyti: ne lidhje me kriterin e afatit kohor te analizës ne i qendrojme pot e njejtit argument ashtu sic ju kemi cituar edhe me vendimet e meparshme qe ju keni dhene.”*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar: *“Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi paraqitjen e fletë analizës nga ISHP per analizat si me poshte : Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd) Kromi (Cr), Nikeli( Ni), Densiteti ose Analizimi i metaleve te renda të kimikateve te behet në nje laborator te licencuar.*

*Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kërkesën për kualifikim që ofertuesit të paraqesin fletë analize të lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik për ato parametra që i realizon ky institucion,*

dhe për analizën e parametrave që nuk kryhen nga ky i fundit, autoriteti kontraktor, ka parashikuar mundësinë që këto analiza të kryhen edhe nga laboratorë të tjerë shtetëror apo privat të licencuar në Republikën e Shqipërisë por çfarë është me e rëndësishme nuk ka përcaktuar laboratorët e tjere të akredituar (ne dijeninë tonë edhe ne shkresat që kemi shkëmbyer me shume institucione nuk ka asnjë laborator të akredituar që kryen Analizat e Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi). A.kontraktor duhet ta rishikojë këtë kriter duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu, në përcaktimin e këtyre organizmave ose institucioneve konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja, autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre llojeve analizash. Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete të akredituara, që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre llojeve analizash toksikologjike.

Sfidojmë Autoritetin Kontraktor të na japë Laboratorin e akredituar me emer (theksojmë të akredituar) që kryen analizën e mallrave objekt prokurimi për elementet që Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) nuk kryen.

Kerkojmë që AK të pranojë analizën e ISHP-se vetëm me ato elemente që kryen ky institucion duke qenë se është institucioni shtetëror me i lartë dhe i vetëm i akredituar që kryen këto analiza, gjithashtu është institucioni që ka standardin shtetëror Shqiptarë, të njohura nga Ministria e Shëndetësisë, që ka në varesi Institutin e Shëndetit Publik (ISHP)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Njëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes për procedurën e mësipërme të prokurimit, protokolluar me tonën me nr. 452/2, datë 29.02.2024, dhe përmes shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr. 452/3 prot., datë 01.03.2024, i cili ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, duke argumentuar: “[...] Në lidhje me ankesën e paraqitur, na u vendos në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm: Procesverbali i hartimit të kriterëve. Dokumentet Standarde të Tenderit. Nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve që subjekti ka kërkuar janë si më poshtë vijon: Në kapitullin e Specifikimeve Teknike pika 2.3.3 thuhet: 2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit)

- Për pretendimin e ngritur në pikën 2.3.3. nga Operatori Ekonomik ankimes “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për ndryshimin e specifikimeve teknike, për të pranuar vetëm elementët që kryen ISHP-ja dhe modifikimit të standardit S SH EN 937:2016 të po atij standardi që ISHP kryen, si organi më i lartë përgjegjës dhe Laboratori i vetëm i akredituar në Republikën e Shqipërisë për kryerjen e Analizave të Hipoklorit Kalciumi. Pretendimi i Operatorit Ekonomik qëndron pjesërisht dhe duhet të bëhet ndryshimi në Specifikimet Teknike si më poshtë:

a) Specifikimet janë hartuar në përputhje me standardet Shëndetësore Shqiptare përkatës, konkretisht: - Hipoklorit i Natriumit - Hipoklorit Kalciumi S SH EN 901:2013

b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit) në sistemin elektronik fletë e analizë për elementët që Instituti i Shëndetit Publik nuk i realizon, duhet të sjellë fletë analizë të metaleve të rënda nga një laborator i licencuar (vendas ose të huaj), Qendra Kërkimore 4 (IKV, IFBZ), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë (Densiteti), apo Universitare që ka kapacitet dhe aparatura që analizojnë metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpërmendura. (Për të gjithë elementët të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik).

#### VENDOSI:

Bazuar në shqyrtimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, ankesa e Operatorit Ekonomik “Albania Distribution Chemicals Sh.p.k” të pranohet pjesërisht.

Në zbatim të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, neni 102, kjo shkresë do t’ju dërgohet në rrugë shkresore si dhe në adresën elektronike që ju keni përcaktuar në formularin e ankesës.

Ky formular do ti dërgohet gjithashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.2. Pavarësisht se autoriteti kontraktor përmes shkresës së mësipërme ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, nga mënyra se si ka vendosur të hartojë dokumentet e tenderit për pjesën e pranuar të ankesës, KPP gjykon, se nuk ndodhemi para rastit ku autoriteti kontraktor vendos pranimin e pjesshëm të ankesës dhe për këtë fakt KPP bazuar në nenin 115 të *lex specialis* do të procedonte me mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar. Në këtë rast KPP gjykon, se pavarësisht se autoriteti kontraktor informon se ka pranuar pjesërisht ankesën, nga mënyra e hartimit të kriterit që do modifikohet jemi para mospranimit të tij, ndaj KPP do të gjykojë në themel pretendimin e operatorit ekonomik ankimes. Lidhur me pretendimin më sipër KPP vëren se,

III.1.3. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.3. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik (I.SH.P.), brenda 3 muajve të fundit, për analizë toksikologjike për produktet që prokurohen (Ofertuesi është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin e mësipërm për ato elementë toksikologjikë që realizon I.SH.P.) ose (certifikatën e analizës toksikologjike të produkteve lëshuar nga laboratorë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi të Republikës të Shqipërisë).

III.1.4. Modifikimi i kriterit sipas aktit të autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së protokolluar me tonën, me shkresat me nr. 452/2 prot., datë 29.02.2024 dhe nr. 452/4 prot., datë 01.03.2024, është si më poshtë:

b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit) në sistemin elektronik fletë e analizë për elementët që Instituti i Shëndetit Publik nuk i realizon, duhet të sjellë fletë analizë të metaleve të rënda nga një laborator i licencuar (vendas ose të huaj), Qendra Kërkimore 4 (IKV, IFBZ), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë (Densiteti), apo Universitare që ka kapacitet dhe aparatura që analizojnë metalet e rënda në

*produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpërmendura. (Për të gjithë elementët të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik).*

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*[...]*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.1.6. Në nenin 40, pika 3 dhe pika 6, gërma c, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*[...]*

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit, si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me mallin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere apo specifikime të cilat mund të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në cilësinë e shërbimit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimesit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet pjesëmarrëse disponojnë fletë - analizë për parametrat më sipër shënuar për produktin që prokurohet. Gjithashtu gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e fletë-analizës si më sipër cituar, i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Në këtë mënyrë KPP gjykon, se fletë-analiza në fjalë është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Pas kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, ISHP me shkresën nr.49/1 prot., datë 24.01.2024, ka informuar KPP se : *Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3181/5 Prot, datë 10.01.2024, ku kërkon informacion lidhur me disa standarde për produktet për trajtimin e ujit të pijshëm, përkatësisht për produktet Poliklorur alumini 10+ 0.5%, hipoklorit natriumi 13-15% dhe acid klorhidrik 30-33%, dhe analizat toksikologjike që kryhen për këto produkte në ISHP, ju bëjmë me dije si vijon:*

A. .... *Në produktin Hipoklorit Natriumi në ISHP analizohen këta tregues: klor aktiv (titulli Cl<sub>2</sub>), kadmium, krom, nikel, plumb. Për analizimin e këtyre treguesve, përdoren metoda analitike të bazuara në Standardin SSH EN 901: 2007 "Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor Hipokloriti i natriumit", i cili përshkruan edhe metodat analitike që duhet të përdoren për analizimin e këtij produkti. ..."*

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kërkesën për kualifikim që ofertuesit të paraqesin fletë - analize të lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik për ato parametra që i realizon ky institucion, dhe për analizën e parametrave që nuk kryhen nga ky i fundit, autoriteti kontraktor, ka parashikuar mundësinë që këto analiza të kryhen edhe nga laboratorë të tjerë shtetërorë apo privatë të licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe ka përcaktuar si të tillë, Qendra Kërkimore 4 (*Laboratorin e Institutit të Kërkimeve Veterinare (IKV) dhe laboratorin e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë (Densiteti) apo Universitare që ka kapacitet dhe aparatura dhe aparatura që analizojnë metalet e rënda në produkte të ndryshme përfshirë edhe kimikatet e sipërpërmendura. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), nuk rezulton që IKV dhe IBZ, të jenë në listën e organeve të akredituara. Në këtë kuadër, nga shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave në lidhje me këtë procedurë prokurimi, nga përgjigja e ISHP-së me përmbajtje si më sipër cituar, si dhe nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të DPA, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet ta rishikojë*



këtë kriter duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja, të cilat mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu, në përcaktimin e këtyre organizmave ose institucioneve konkrete private ose shtetërore të akredituara vendase ose të huaja, autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre llojeve analizash. Për sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete të akredituara, që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre llojeve analizash toksikologjike.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit, “Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vendosur. Referuar dokumentacionit të Procedurës së Prokurimit, vendosja e kërkesës jo më vonë se 3 muaj nga data e hapjes së procedurës së prokurimit, tek Kapaciteti teknik, pika 2.3.3 e kërkesës për fletë analizë toksikologjike ose dëshmi të testimeve, nuk i shërben objektit të prokurimit, pasi në kthim përgjigjen e Institutit të Shëndetit Publik me nr. 513/1 prot., datë 26.05.2023, për kërkesën e bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 963/7 prot., datë 18.05.2023 mbi afatin ligjor të vlefshmërisë së një raporti analize, nga ky institucion është sqaruar se raporti i analizës në çdo rast është i vlefshëm vetëm për mostrën e sjellë në ISHP, çka është shënuar edhe në raportin e analizës. Për pasojë kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenet përkatëse: nenet 40 dhe 77 të LPP-së dhe nenit 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar qartë kriteret e nevojshme në procedurat e prokurimit për kontratat e mallrave, përmbushja e të cilave i jep siguri Autoritetit Kontraktor, që operatorët ekonomikë janë në gjendje të realizojnë me sukses kontratën. “Kapaciteti teknik”, jo më vonë se 3 muaj nga data e hapjes së procedurës së prokurimit, për sa i përket kriterit për paraqitjen e fletë analizës toksikologjike ose dëshmi të testimeve, është një kërkesë e panevojshme, jo në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit. Gjykojmë, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar kriteret për kualifikim, në përputhje me nevojat reale dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.”

III.2.1 Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7, “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.3. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik (I.SH.P.), brenda 3 muajve të fundit, për analizë toksikologjike për produktet që prokurohen (Ofertuesi është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin e mësipërm për ato elementë

*toksikologjikë që realizon I.SH.P.) ose (certifikatën e analizës toksikologjike të produkteve lëshuar nga laboratorë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi të Republikës të Shqipërisë).*

III.2.2. Modifikimi sipas aktit të autoriteti kontraktor për trajtimin e ankesës së protokolluar me tonën me shkresat me nr. 452/2 prot., datë 29.02.2024 dh nr. 452/4 prot., datë 01.03.2024 është si më poshtë:

*b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit) në sistemin elektronik fletë e analizë për elementët që Instituti i Shëndetit Publik nuk i realizon, duhet të sjellë fletë analizë të metaleve të rënda nga një laborator i licencuar (vendas ose të huaj), Qendra Kërkimore 4 (IKV, IFBZ), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë (Densiteti), apo Universitare që ka kapacitet dhe aparatura që analizojnë metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpërmendura. (Për të gjithë elementët të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik).*

III.2.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.3. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “ 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe 10 kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

III.2.5 Referuar kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vendosur. Referuar dokumentacionit të Procedurës së

Prokurimit, vendosja e kërkesës për “certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit”, te Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, kërkesë për certifikatë analize nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit), nuk i shërben objektit të prokurimit, pasi në kthim përgjigjen e Institutit të Shëndetit Publik me nr. 513/1 prot., datë 26.05.2023, për kërkesën e bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 963/7 prot., datë 18.05.2023, mbi afatin ligjor të vlefshmërisë së një raporti analize, nga ky institucion është sqaruar, se raporti i analizës në çdo rast është i vlefshëm vetëm për mostrën e sjellë në ISHP, çka është shënuar edhe në raportin e analizës. Për pasojë, kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenet përkatëse: nenet 40 dhe 77 të LPP-së dhe nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar qartë kriteret e nevojshme në procedurat e prokurimit për kontratat e mallrave, përmbushja e të cilave i jep siguri Autoritetit Kontraktor, që operatorët ekonomikë janë në gjendje të realizojnë me sukses kontratën.

III.2.6. KPP vëren, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregullat, të hollësishme për të gjitha palët në proces. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit duhet të përcaktohen qartë, saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të mos rëndojnë mbi operatorët ekonomikë me kërkesa të tepërta dhe të panevojshme, por të fokusohen në ato kritere, realizimi i të cilave jep një informacion mbi operatorët ekonomikë dhe siguri autoritetit kontraktor, me qëllimin final të përmbushjes me sukses të procedurës së prokurimit. Për sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe kthim - përgjigjes së Institutit të Shëndetit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024 me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fioorent Zguro**

